



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.49

28 prill

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr.32, datë 22.4.2010	Për zgjedhjen e Avokatit të Prokurimeve 1811
Vendim i Kuvendit nr.33, datë 22.4.2010	Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi 1811
Rezolutë e Kuvendit datë 22.4.2010	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2009 1812
Rezolutë e Kuvendit datë 22.4.2010	Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2009 1813
Vendim i KM nr.242, datë 13.4.2010	Për një shtesë në vendimin nr.362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar 1814
Vendim i KM nr.243, datë 13.4.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor bulevardi “Bajram Curri” deri në rrugën “Ali Demi” 1815
Vendim i KM nr.244, datë 13.4.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Korçë – Qafëplloçë 1816

Vendim i KM nr.245, datë 13.4.2010	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të objekteve “Ofiçina e filialit të ish-sizmikës”, Fier, dhe “Ish-parku komunal”, Elbasan, si dhe për një ndryshim në vendimin nr.226, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit”	1826
Vendim i KM nr.246, datë 13.4.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.1180, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit”, të ndryshuar	1827
Vendim i KM nr.248, datë 13.4.2010	Për një shtesë në vendimin nr.207, datë 9.5.2002 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e punëve të vështira dhe të rrezikshme”	1828
Vendim i KM nr.250, datë 13.4.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.12, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës, me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar”	1828
Vendim i KM nr.251, datë 13.4.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.200, datë 19.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar”	1829
Vendim i KM nr.252, datë 13.4.2010	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 13.11.2007 për çështjen nr.38222/02, “Rramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”	1830
Vendim i KM nr.259, datë 27.4.2010	Për lirimimin dhe emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave	1831
Vendim i ERRU nr.2, datë 18.1.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u. Gramsh	1832
Vendim i ERRU nr.3, datë 18.1.2010	Për licencimin e operatorit ndërmarrja e u.k., bashkia Pukë .	1832
Vendim i ERRU nr.6, datë 16.2.2010	Për licencimin e operatorit sh.a., Ujësjellës, Vlorë	1833
Vendim i ERRU nr.7, datë 19.2.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u.k. Korçë	1833
Vendim i ERRU nr.8, datë 25.2.2010	Për rilicencimin e operatorit për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik sh.a.u., Përmet	1834
Vendim i ERRU nr.9, datë 1.3.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u.k., Fier	1834

VENDIM
Nr.32, datë 22.4.2010

PËR ZGJEDHJEN E AVOKATIT TË PROKURIMEVE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 15 e 76 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Altin Qoshja zgjidhet në detyrën e Avokatit të Prokurimeve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.33, datë 22.4.2010

PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Në mbështetje të neneve 23 dhe 24 të ligjit nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Irma Baraku zgjidhet në detyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2009

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur veprimtarinë e Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues i pavarur jogjyqësor, në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

- Duke vlerësuar rolin e këtij institucioni të paanshëm si kontribues për rritjen e transparencës së administratës publike në nivel qendror e vendor, sistemit gjyqësor dhe prokurorisë në raport me shtetasit, nëpërmjet rekomandimeve të dhëna dhe masave të propozuara;

- Duke mbështetur fuqimisht veprimtarinë e këtij institucioni në funksion të përmirësimit dhe arritjes së standardeve më të larta në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe kontributit të dhënë për përmirësimin e legjislacionit vendas, sipas frymës së standardeve ndërkombëtare,

Konstaton se për vitin 2009:

- Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit ka pasur si objektiv mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë, në përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar;

- Avokati i Popullit ka punuar për realizimin e objektivave, sipas rezolutës së miratuar nga Kuvendi;

- Ka zhvilluar një intensitet pune të konsiderueshëm, duke orientuar shtetasit edhe në rastin e ankesave jashtë juridiksionit, si dhe moskompetencën e institucionit në trajtimin e rasteve të tilla;

- Ka ushtruar kompetencat kushtetuese si subjekt që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Në raste të veçanta pozicioni i Avokatit të Popullit ka qenë preferencial;

- Njësia për Parandalimin e Torturës ka pasur rritje të performancës së punës në raport me vitin e kaluar;

- Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshillin e Ministrave, institucionet e tjera qendrore dhe ato të pavarura kanë ardhur duke u përmirësuar në mënyrë të ndjeshme;

- Marrëdhëniet me shtetasit shqiptarë, duke shkuar si institucion pranë tyre në bashki, komuna apo qarqe, kanë dhënë rezultate të dukshme në punën e tij.

Për vitin 2010 Kuvendi kërkon:

- Metodologjia, mënyra e raportimit vjetor të institucionit të Avokatit të Popullit të ndryshojë, duke pasqyruar një analizë të çështjeve, të fenomenologjisë dhe tipologjisë së tyre, si dhe përgjithësime mbi bazën e praktikës së deritanishme. Ky raport duhet të parashtrorë rekomandime dhe të deklarojë zyrtarisht konkluzionin mbi gjendjen e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin në vijim;

- Rritjen e rolit sensibilizues të Avokatit të Popullit për informimin e shtetasve, lidhur me misionin dhe kompetencat që ky institucion ushtron për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe konsolidimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me median e shkruar dhe atë vizive, për vijimin e komunikimit të drejtpërdrejtë me të gjithë shtetasit shqiptarë;

- Angazhim më të fortë publik në mbrojtje të interesave të shtetasve, në mënyrë të veçantë për sistemin gjyqësor: në lidhje me vonesën e gjykimeve, mosaplikimin e dënimeve alternative, gabimet në llogaritjen e afateve të paraburgimit, vendimet lidhur me masat e sigurimit, vuajtjen e dënimit në burgjet e sigurisë së lartë të personave të moshuar ose me probleme fizike etj.;

- Angazhim më të fortë publik në mbrojtje të interesave të shtetasve, në mënyrë të veçantë në lidhje me sistemin e Prokurorisë: në mosrespektimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale nga ana e organit të akuzës, lidhur me mbajtjen përtej afateve ligjore në organet e vuajtjes së dënimit të personave, të cilëve u ka kaluar afati i vuajtjes së dënimit, duke lëshuar me vonesë urdhrin e lirim, duke zvarritur hetimin e çështjeve penale, për moskryerje të gjithanshme dhe objektive të hetimeve, për akuzë të padrejtë apo për rëndim të akuzës;

- Angazhim më të fortë publik në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë, në lidhje me pushtetin vendor: në mënyrë të veçantë për bashkitë dhe komunitet, për zbatimin e legjislacionit të qeverisjes vendore, për respektimin e parimit të decentralizimit, për ofrimin e shërbimeve për shtetasit në nivel vendor etj.;

- Respektimin e kompetencave kushtetuese, në rastin e investimit të Gjykatës Kushtetuese nga ana e Avokatit të Popullit;

- Eliminimin e trajtimit preferencial të ankesave të shtetasve;

- Eliminimin e të gjitha deklarimeve me përmbajtje apo sjellje politike nga ana e këtij institucioni;

- Konsolidimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit e të mirëkuptimit si me organizmat ndërkombëtarë, ashtu edhe me forcat politike, shoqërinë civile dhe organizatat jofitimprurëse;

- Monitorimin aktiv të rekomandimeve të bëra dhe masave të propozuara nga Avokati i Popullit drejtuar institucioneve shtetërore dhe administratës publike.

22 prill 2010

REZOLUTË **PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT** **PËR VITIN 2009**

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur e vlerësuar rolin kushtetues të Kontrollit të Lartë të Shtetit për kontrollin e veprimtarisë ekonomike të institucioneve qendrore e vendore që përdorin fonde publike;

- Duke vlerësuar kontributin e tij për përmirësimin e administrimit të fondeve publike;

- Duke vlerësuar rolin e këtij institucioni për t'i siguruar Kuvendit, drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe publikut, në përgjithësi, informacionin e nevojshëm për administrimin e fondeve publike;

- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare të fushës së kontrollit ekonomik e financiar;

Konstaton se gjatë vitit 2009 Kontrolli i Lartë i Shtetit:

- Ka zbatuar detyrimet e përcaktuara në Kushtetutë, ligjin organik për Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe planin e zhvillimit strategjik për periudhën 2009-2012;

- Ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me standardet e kontrollit, rregulloren e brendshme, manualin, si dhe dokumentet e tjera të institucionit;

- Ka përmirësuar dhe plotësuar metodologjinë e kontrollit, mbështetur në standardet e kontrollit të INTOSAI-t dhe produktet e projektit të bashkëpunimit me institucionet homologe të vendeve partnere;

- Ka përmirësuar cilësinë e veprimtarisë kontrolluese, nëpërmjet ndërtimit të një sistemi të kontrollit të performancës;

- Ka rritur efektivitetin e veprimtarisë së tij, nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë dhe rritjes profesionale të stafit kontrollues; ka rritur forcën zbuluese të kontrollit, si dhe ka rekomanduar zhdëmtimin dhe arkëtimin në Buxhetin e Shtetit të dëmit ekonomik të konstatuar;

- Ka rekomanduar marrjen e masave me karakter organizativ, administrativ e ligjor për rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike, si dhe ka ushtruar kontroll për zbatimin e tyre nga drejtuesit e institucioneve të ndryshme;

- Ka përdorur me efektivitet fondet buxhetore të institucionit, duke reduktuar shpenzimet për veprimtarinë kontrolluese;

- Ka rritur bashkëpunimin me organet e kontrollit të brendshëm në drejtim të programimit të subjekteve e të tematikave të kontrollit;

- Ka dhënë kontribut, nëpërmjet rekomandimeve, për përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore;
- Ka informuar periodikisht institucionet e përcaktuara me ligj dhe publikun për rezultatet e veprimtarisë së tij kontrolluese.

Kuvendi kërkon që për vitin 2010 Kontrolli i Lartë i Shtetit të thellojë më tej përvojën në drejtimet e mëposhtme:

- Rritjen e pavarësisë së institucionit dhe organizimin e kontrolleve me cilësi, efektivitet të lartë, objektivitet e profesionalizëm;
- Përdorimin gjerësisht të metodologjisë bashkëkohore në kontroll, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira në fuqi; përqendrimin e kontrollit në subjektet me rëndësi të veçantë për ekonominë, të cilat menaxhojnë vlera të mëdha materiale dhe financiare në qeverisjen qendrore dhe vendore;
- Rritjen e cilësisë dhe të performancës gjatë kontrollit për përdorimin e kapitalit dhe të fondeve të huazuara nga institucionet financiare ndërkombëtare;
- Konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin, në mënyrë të veçantë me Komisionin për Ekonominë dhe Financat, me Këshillin e Ministrave dhe institucionet qendrore, për përmirësimin e legjislacionit dhe administrimin e vlerave materiale e monetare; fuqizimin e bashkëpunimit me organet e drejtësisë, për të vënë para përgjegjësisë shkelësit e ligjit;
- Rritjen e nivelit profesional të stafit, veçanërisht të atij kontrollues;
- Forcimin e bashkëpunimit me strukturat e auditit të brendshëm, si dhe harmonizimin e veprimtarisë me to.

Kuvendi përcakton si objektiva të tij, në raport me Kontrollin e Lartë të Shtetit:

- Forcimin e bashkëpunimit me këtë institucion, për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit;
- Sigurimin e mbështetjes ndaj institucionit, për t'i krijuar atij të gjitha kushtet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë;
- Realizimin e detyrimit ligjor për auditimin dhe kontrollin e veprimtarisë financiare dhe administrative të institucionit;
- Bashkëpunimin më të mirë dhe me efektivitet të Prokurorisë me Kontrollin e Lartë të Shtetit për administrimin dhe përdorimin e fondeve publike.

22 prill 2010

VENDIM
Nr.242, datë 13.4.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.362, DATË 1.4.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 2, e 20 të ligjit nr. 9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen “Formati tip nr.5-Lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin”, të përmendur në pikën 9 të kreut II “Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë”, të vendimit nr.362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet edhe: “...Serbia me dokumentin pasaportë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.243, datë 13.4.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR BULEVARDI “BAJRAM CURRI” DERI NË RRUGËN “ALI DEMI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajjtshme, pronë private, tokë truall, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor bulevardi “Bajram Curri” deri në rrugën “Ali Demi”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurisë së paluajjtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 5 621 (pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e një) m², tokë truall, me çmimet konfirmuar nga ZRKKP-ja përkatëse, me vlerë të përgjithshme 167 668 810 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dhjetë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 357 500 (treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga bashkia e Tiranës.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 167 668 810 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dhjetë) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.5.2010 dhe të përfundojë më 1.8.2010.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë bashkisë së Tiranës.

8. Bashkia e Tiranës të kryejë likuidimin e pronarëve, brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT URBANISTIK
BULEVARDI “BAJRAM CURRI” RRUGA-“ALI DEMI”

LISTA E PRONARËVE, VLERA NË LEKË DHE SIPËRFAQJA QË PREKET,
SIPAS DOKUMENTEVE TË DORËZUARA

Nr.	Emër, mbiemër	ZK.	Nr.pas	Truall	Çmimi	Objekt	Çmimi	Vlefte	Lloji i pasurisë
1	Fatime Keta+6 bashkpr.	8150	8/509	1417 m ²	29829			42,267,693	Certifikatë pronësie
2	Fejzi Kycyku+8 bashkpr.	8150	8/64	139 m ²	29829			4,146,231	Certifikatë pronësie
3	Shefqet Pengili+11 bashkpr.	8150	8/269	140 m ²	29829			4,176,060	Certifikatë pronësie
4	Njazi Çuadari +1 bashkpr.	8150	8/614	237 m ²	29829			7,069,473	Certifikatë pronësie
5	Bashkim Mema+4 bashkpr.	8150	8/644	238 m ²	29829			7,099,302	Certifikatë pronësie
6	Hajrije Selita+4 bashkpr.	8150	8/630	390 m ²	29829			11,633,310	Certifikatë pronësie
7	Lefteri Rudha+3 bashkpr.	8150	8/628	65 m ²	29829			1,938,885	Certifikatë pronësie
8	Serveta Keta	8150	8/523	52,5 m ²	29829			1,566,023	Certifikatë pronësie
9	Besnik Keta	8150	8/524	52,5 m ²	29829			1,566,023	Certifikatë pronësie
10	Merita Keta	8150	8/525	20 m ²	29829			596,580	Certifikatë pronësie
11	Romina Keta	8150	8/526	2 m ²	29829			59,658	Certifikatë pronësie
12	Vladimir Luçi	8150	8/450	72 m ²	29829			2,147,688	Certifikatë pronësie
13	Arjan Hyka+3 bashkpr.	8150	8/542	317 m ²	29829			9,455,793	Vërtetim pronësie
14	Bajram Çeliku+10 bashkpr.	8150	8/449	2479 m ²	29829			73,946,091	Vërtetim pronësie
	Totali			5621 m²				167,668,810	

VENDIM
Nr.244, datë 13.4.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR KORÇË – QAFËPËLLOÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8, të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Korçë – Qafëpëllaçë.
- Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
- Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 14 060 (katërbëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë) m², tokë arë, me vlerë 5 575 240.7 (pesë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e dyzet pikë shtatë) lekë, për sipërfaqen 2 609 (dy mijë e gjashtëqind e nëntë) m², tokë truall, me vlerë 6 605 294 (gjashtë milionë e gjashtëqind e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 12 180 534.7 (dymbëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër pikë shtatë) lekësh.
- Shpenzimet procedurale, në vlerën 1 172 500 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
- Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 12 180 534.7 (dymbëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër pikë shtatë) lekë, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
- Shpronësimi të fillojë më 20.4.2010 dhe të përfundojë më 20.7.2010.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 6, të këtij vendimi në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

RRUGA KORÇË - PLOÇË
Komuna BULGAREC
Fshati BIRANJ

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	NR. Pas.	TOKË ARË			TOKË TRUALL			Vlera Totale Lekë	Shënime
						SIP (m ²)	Çmimi (Leke/m ²)	VLERA (LEKË)	SIP (m ²)	Çmimi (Leke/m ²)	VLERA (LEKË)		
1	Seran	Zenel	Bace	1189	44/5	606	372.7	225856.2				225856.2	Konfirmuar nga ZRPP
2	Petro	Koco	Zguro	1189	33/103				1031	2461	2537291	2537291	Konfirmuar nga ZRPP
3	Behar	Faik	Roko	1189	44/21	67	372.7	24970.9				24970.9	Konfirmuar nga ZRPP
4	Kujtim		Topulli	1189	44/22				69	2461	169809	169809	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				673		250827.1	1100		2707100	2957927.1	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

RRUGA KORÇË - PLOÇË
Komuna BULGAREC
Fshati ÇIFLIG

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	NR. Pas.	TOKË ARË			Shënime
						SIP (m ²)	Çmimi (Lekë/m ²)	VLERA (LEKË)	
1	Artur	Vasil	Goçllari	1403	175/94	52	416.6	21663.2	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				52		21663.2	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

RRUGA KORÇË - PLOÇË
Komuna ÇERRAVE
Fshati LESHNICE

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kad.	Numuri i pasurisë	TOKË ARË			Shënime
						SIP (m ²)	Çmimi (Lekë/m ²)	Vlera Lekë	
1	Nexhat		Cuka	2420	110/51	114	534.4	60921.6	Konfirmuar nga ZRPP
2	Mahmudi		Hoxha	2420	195/28	163	534.4	87107.2	Konfirmuar nga ZRPP
3	Hasan	Rakip	Pengu	2420	108/30	50	534.4	26720	Konfirmuar nga ZRPP
4	Mitat	Qani	Cane	2420	113/3	26	534.4	13894.4	Konfirmuar nga ZRPP
5	Guri	Bilal	Lipo	2420	13/10	785	534.4	419504	Konfirmuar nga ZRPP
6	Skender	Muharrem	Alinj	2420	195/19	155	534.4	82832	Konfirmuar nga ZRPP
7	Ibrahim	Qazim	Alinj	2420	195/20	28	534.4	14963.2	Konfirmuar nga ZRPP
8	Bajram	Qazim	Alinj	2420	195/21	28	534.4	14963.2	Konfirmuar nga ZRPP
9	Rahman	Qazim	Alinj	2420	195/22	24	534.4	12825.6	Konfirmuar nga ZRPP
10	Fari & Hydri		Ibi	2420	195/23	25	534.4	13360	Konfirmuar nga ZRPP
11	Fari & Hydri		Ibi	2420	195/24	25	534.4	13360	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				1423		760451.2	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

RRUGA KORÇË - PLLOÇË
Komuna BULGAREC
Fshati BULGAREC

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	NR. Pas.	TOKË ARË			TOKË TRUALL			VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
						SIP (m ²)	Çmimi (Lekë/m ²)	VLERA (LEKË)	SIP (m ²)	Çmimi (Lekë/m ²)	VLERA (LEKË)		
1	Veiz		Lleshnja	1310	121/29	20	534.1	10682				10682	Konfirmuar nga ZRPP
2	Hysen	Muarem	Larti	1310	121/2	108	534.1	57682.8				57682.8	Konfirmuar nga ZRPP
3	Xhelal	Muarem	Larti	1310	121/1	96	534.1	51273.6				51273.6	Konfirmuar nga ZRPP
4	Bardhyl	Karafil	Larti	1310	200/8				255	2551	650505	650505	Konfirmuar nga ZRPP
5	Seit	Karafil	Larti	1310	200/2				351	2551	895401	895401	Konfirmuar nga ZRPP
6	Namik		Larti	1310	200/7				90	2551	229590	229590	Konfirmuar nga ZRPP
	Bardhyl		Larti										Konfirmuar nga ZRPP
	Seit		Larti										Konfirmuar nga ZRPP
	Hetem		Durmishllari										Konfirmuar nga ZRPP
	Ditar		Durmishllari										Konfirmuar nga ZRPP
	Brunilda		Hoxha										Konfirmuar nga ZRPP
	Illir		Durmishllari										Konfirmuar nga ZRPP
7	Namik	Karafil	Larti	1310	200/1				367	2551	936217	936217	Konfirmuar nga ZRPP
8	Esat	Rakip	Vija	1310	118/2	431	534.1	230197.1				230197.1	Konfirmuar nga ZRPP
9	Faik	Rakip	Vija	1310	118/3	502	534.1	268118.2				268118.2	Konfirmuar nga ZRPP
10	Genci	Vebi	Larti	1310	118/4	387	534.1	206696.7				206696.7	Konfirmuar nga ZRPP
11	Adem	Amet	Larti	1310	118/5	402	534.1	214708.2				214708.2	Konfirmuar nga ZRPP
12	Fadil	Adem	Larti	1310	118/6	255	534.1	136195.5				136195.5	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				2201		1175554.1	1063		2711713	3887267.1	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

RRUGA KORÇË - PLLOÇË
Komuna ÇERRAVE
Fshati GRABOVICË

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zon Kad.	Nr. i Pas	TOKË ARË			Shënime
						SIP (m ²)	Çmimi (L/m ²)	VLERA (LEKË)	
1	Ramadan	Jaçe	Bakollari	1832	247/3	160	257.6	41216	Konfirmuar nga ZRPP
TOTALI						160		41216	

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

RRUGA KORÇË - PLLOÇË
Komuna LIBONIK
Fshati LIBONIK

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	NR. Pas.	TOKË ARË			TOKË TRUALL			VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
						SIP (m ²)	Çmimi (Lekë/m ²)	VLERA (LEKË)	SIP (m ²)	Çmimi (Lekë/m ²)	VLERA (LEKË)		
1	Nexhip	Alush	Merolli	2445	36/1/2				212	2371	502652	502652	Konfirmuar nga ZRPP
2	Mirdash	Skender	Mucka	2445	39/10	30	409.6	12288				12288	Konfirmuar nga ZRPP
3	Astrit	Murat	Muço	2445	37/1-40	118	409.6	48332.8				48332.8	Konfirmuar nga ZRPP
4	Shpetim		Merolli	2445	36/1/1				93	2371	220503	220503	Konfirmuar nga ZRPP
5	Kadri	Tosun	Mersinllari	2445	103/1	505	409.6	206848				206848	Konfirmuar nga ZRPP
6	Osman	Vait	Mersinllari	2445	103/2	255	409.6	104448				104448	Konfirmuar nga ZRPP
7	Gafer	Seit	Mersinllari	2445	103/3	138	409.6	56524.8				56524.8	Konfirmuar nga ZRPP
8	Nezhdet	Seit	Mersinllari	2445	103/4	134	409.6	54886.4				54886.4	Konfirmuar nga ZRPP
9	Lytfi	Tosun	Mersinllari	2445	103/5	170	409.6	69632				69632	Konfirmuar nga ZRPP
10	Adelina	Lytfi	Mersinllari	2445	103/6	49	409.6	20070.4				20070.4	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				1399		573030.4	305		723155	1296185.4	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

RRUGA KORÇË - PLOÇË
Komuna PIRG
Fshati SOVJAN

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	NR. PAS	TOKË ARË			TOKË TRUALL			VLERA TOTALE	SHËNIME
						SIP (m ²)	Çmimi (Lekë/m ²)	VLERA (LEKË)	SIP (m ²)	Çmimi (Lekë/m ²)	VLERA (LEKË)		
1	Pellumb		Rakipllari	3496	1647/10	126	394.4	49694.4				49694.4	Konfirmuar nga ZRPP
2	Fatmir	Hasan	Rakipllari	3496	1647/23	89	394.4	35101.6				35101.6	Konfirmuar nga ZRPP
3	Edmond	Xhezar	Rakipllari	3496	1636/18	53	394.4	20903.2				20903.2	Konfirmuar nga ZRPP
	Lejla	Bajram	Rakipllari									0	Konfirmuar nga ZRPP
4	Hekuran	Qani	Bakollari	3496	1571/69	90	394.4	35496				35496	Konfirmuar nga ZRPP
5	Pellumb	Kamber	Rakipllari	3496	1571/59	15	394.4	5916				5916	Konfirmuar nga ZRPP
6	Halil		Avdillari	3496	1729/40	81	394.4	31946.4				31946.4	Konfirmuar nga ZRPP
7	Gesim	Ramadan	Dautllari	3496	694/23	29	394.4	11437.6				11437.6	Konfirmuar nga ZRPP
8	Bajram	Gani	Bako	3496	666/30	105	394.4	41412				41412	Konfirmuar nga ZRPP
9	Hekuran	Bektash	Hyska	3496	1712/12	24	394.4	9465.6				9465.6	Konfirmuar nga ZRPP
10	Nevzat		Dautllari	3496	1712/13	246	394.4	97022.4				97022.4	Konfirmuar nga ZRPP
11	Bujar		Xhepo	3496	1712/32	99	394.4	39045.6				39045.6	Konfirmuar nga ZRPP
12	Izja	Nazar	Ismaili	3496	1709/1	958	394.4	377835.2				377835.2	Konfirmuar nga ZRPP
13	Dervish	Shasho	Bici	3496	1590/4	232	394.4	91500.8				91500.8	Konfirmuar nga ZRPP
14	Altin	Ilmi	Hysenllari	3496	1590/6	66	394.4	26030.4				26030.4	Konfirmuar nga ZRPP
15	Altin	Ilmi	Hysenllari	3496	1590/7	82	394.4	32340.8				32340.8	Konfirmuar nga ZRPP
16	Skender	Çelnik	Kreka	3496	1590/8	153	394.4	60343.2				60343.2	Konfirmuar nga ZRPP
17	Violeta	Bexhet	Bono	3496	1590/10	225	394.4	88740				88740	Konfirmuar nga ZRPP
18	Myfit	Nevruz	Fetollari	3496	1590/11	44	394.4	17353.6				17353.6	Konfirmuar nga ZRPP
19	Artan	Rakip	Xhemollari	3496	695/1	35	394.4	13804	141	3286	463326	477130	Konfirmuar nga ZRPP
20	Qazim	Selim	Avdillari	3496	695/2	49	394.4	19325.6				19325.6	Konfirmuar nga ZRPP
21	Alitruje	Arif	Bicaku	3496	1600/17	520	394.4	205088				205088	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				3321		1309802.4	141		463326	1773128.4	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

RRUGA KORÇË - PLLOÇË
Komuna PIRG
Fshati VELITERNE

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	NR. Pas.	TOKË ARË			Shënime
						SIP (m ²)	Çmimi (L/m ²)	VLERA (LEKË)	
1	Astrit		Kolonjari	3736	302/8	1071	256.3	274497.3	Konfirmim nga ZRPP
2	Pellumb		Laraku	3736	67/32	65	256.3	16659.5	Konfirmim nga ZRPP
3	Shefqet		Laraku	3736	67/34	76	256.3	19478.8	Konfirmim nga ZRPP
4	Anesti		Laraku	3736	67/35	230	256.3	58949	Konfirmim nga ZRPP
5	Çelnik		Metollari	3736	67/36	125	256.3	32037.5	Konfirmim nga ZRPP
6	Syrja		Laraku + Bp.	3736	67/37	44	256.3	11277.2	Konfirmim nga ZRPP
		TOTALI				1611		412899.3	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

RRUGA KORÇË - PLLOÇË
Komuna ÇERRAVE
Fshati ÇERRAVE

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	NR. Pas.	TOKË ARË			Shënime
						SIP (m ²)	Çmimi (L/m ²)	VLERA (LEKË)	
1	Teki	Zylfi	Ibi	1387	325/8	1095	287.6	314922	Konfirmuar nga ZRPP
2	Albert	Lytfi	Ibi	1387	325/10	495	287.6	142362	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				1590		457284	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

RRUGA KORÇË - PLLOÇË
Komuna PIRG
Fshati GURISHTE

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	NR. Pas.	TOKË ARË			Shënime
						SIP (m ²)	Çmimi (Leke/m ²)	Vlera Lekë	
1	Bajram	Qani	Muçollari	1900	356/3	836	352.7	294857.2	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				836		294857.2	

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE
DREJTORIA E SHPRONESIMEVE

RRUGA KORÇË-PLLOÇË
Komuna ÇERRAVË
Fshati PRETUSHE

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	ZK	NR. PAS.	TOKE ARE			Shenime
						SIP (m2)	Çmimi (Leke/m2)	VLERA (LEKE)	
1	Fiqirie	Riza	Leka	3047	136/2	242	330.8	80053.6	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				242		80053.6	

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE
DREJTORIA E SHPRONESIMEVE

RRUGA KORÇE - PLLOÇE
Komuna LIBONIK
Fshati SYMIZ

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	ZK	Nr. Pas.	TOKE ARE			Shenime
						SIP (m2)	Çmimi (Leke/m2)	VLERA (LEKE)	
1	Astrit	Nexhip	Beqollari	3553	48/53	207	259.6	53737.2	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				207		53737.2	

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGEVE
DREJTORIA E SHPRONESIMEVE

RRUGA KORÇE - PLLOÇE
Komuna LIBONIK
Fshati VLOÇISHT

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Zk	Nr. Pas.	TOKE ARE			Shenime
						SIP (m2)	Çmimi (Leke/m2)	VLERA (LEKE)	
1	Rami	Skender	Muçollari	3803	170/36	345	417	143865	Konfrimim nga Zvrpp
		TOTALI				345		143865	

VENDIM
Nr.245, datë 13.4.2010

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT TË OBJEKTEVE “OFIÇINA E FILIALIT TË ISH - SIZMIKËS”, FIER, DHE “ISH-PARKU KOMUNAL”, ELBASAN, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.226, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 14 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 8/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit njësisive të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekti “Ofiçinat e filialit të ish-sizmikës”, Fier, me sipërfaqe 1180 (një mijë e njëqind e tetëdhjetë) m², në pronësi të bashkisë Fier, t’i kalojë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Objekti “Ish-parku komunal”, Elbasan, me sipërfaqe 3 937 (tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) m², në pronësi të bashkisë Elbasan, t’i kalojë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Pronat e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij vendimi t’i bashkëlidhen listës së inventarit të pronave, miratuar me vendimin nr.226, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit”.

4. Pronat sipas pikave 1 e 2 të hiqen nga listat përfundimtare, që i bashkëlidhen vendimeve të Këshillit të Ministrave, përkatësisht, nr.574, datë 28.5.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë Fier të qarkut të Fierit”, dhe nr.416, datë 11.7.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë Elbasan të qarkut të Elbasanit”.

5. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.246, datë 13.4.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1180, DATË 5.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR
LEGALIZIM DHE MBLEDHJEN E ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË PROCESIT
TË LEGALIZIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1180, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Tarifa e shërbimit për legalizimin e objekteve pa leje/shtesave informale në ndërtime me leje, është në vlerën 4 000 (katër mijë) lekë, për çdo kat të objektit pa leje/shtesës informale në ndërtime me leje.”.

2. Nënparagrafët 4.4 dhe 4.5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“4.4 PAGESA E PARCELËS NDËRTIMORE, PËR OBJEKTET INFORMALE ME DESTINACION SOCIAL-EKONOMIK DHE SHTESAT INFORMALE NË NDËRTIME ME LEJE, DO TË BËHET VETËM NË LEKË, NË VLERË TË PLOTË MONETARE.

4.5 PËR OBJEKTET INFORMALE, ME DESTINACION BANIMI APO TË PËRZIER (BANIM DHE SOCIAL-EKONOMIK), PAGESA E VLERËS SË PARCELËS MUND TË BËHET NË LEKË, NË VLERË TË PLOTË MONETARE, DHE/OSE ME BONO PRIVATIZIMI.

Në rastin kur pagesa kryhet me bono privatizimi, ajo duhet të paraprihet nga depozitimi i kërkesës me shkrim, të poseduesit të ndërtimit informal, pranë drejtorisë rajonale të ALUIZNI-t, ku të përcaktohet përqindja e pagesës me bono privatizimi.”.

3. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Sanksionet për subjektet dhe / ose shoqëritë ndërtuese që kanë kryer shtesa anësore ose shtesa në kate, për qëllim kalimi pronësie ose qiradhënieje, llogariten nga ALUIZNI, në përputhje me përcaktimet dhe përqindjet e përcaktuara në nenin 43 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

Për shtesat informale (anësore apo në lartësi), të ngritura në territore (zona) ku nuk ka çmim minimal fiskal, të përcaktuar në përputhje me pikën 2 të nenit 43 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, çmimi minimal fiskal do të llogaritet si mesatare aritmetike e çmimit të zonave me të cilat ky territor (zonë) kufizohet.

5.1 Likuidimi i penaliteteve do të bëhet për llogari të njëjësive të qeverisjes vendore brenda 30 ditëve nga pajisja me formularin e penaliteteve për legalizimin e shtesave informale të subjektit ndërtues.

5.2 Për subjektet dhe/ose shoqëritë ndërtuese të cilat kanë paguar sanksione të mëparshme për shkelje të lejes së ndërtimit, nga vlera totale e sanksioneve do të zbritet vlera e paguar më parë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.248, datë 13.4.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.207, DATË 9.5.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E PUNËVE TË VËSHITIRA DHE TË RREZIKSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 100 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “b” të pikës 1 të vendimit nr.207, datë 9.5.2002 të Këshillit të Ministrave, pas profesionit “Piloti”, të shtohet edhe profesioni “Kontrollor i trafikut ajror”.
2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.250, datë 13.4.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.12, DATË 7.1.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUSHTET DHE PROCEDURËN E TJETËRSIMIT TË
SIPËRFAQEVE TË TOKËS, ME CILËSI TË VEÇANTA, PËR LLOGARI TË FONDIT TË
KOMPENSIMIT FINANCIAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 23 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Në vendimin nr.12, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:
 - a) Në shkronjën “b” fjalët “.....sipas çmimit përkatës, të përcaktuar në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave, sipas metodikës për vlerësimin e pronës së paluajtshme, miratuar me vendimin nr.183, datë 28.4.2005 të Kuvendit.” zëvendësohen me “.....sipas çmimit të përcaktuar në hartën e vlerës së tokës, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.”.
 - b) Në shkronjën “ç” fjalët “....në zyrën e AKKP-së në qendër...” zëvendësohen me “.....në zyrën e AKKP-së...”.
 2. Në pikën 2 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:
 - a) Në fjalinë e parë fjalët “.....pranë zyrës së AKKP-së, në qendër...” zëvendësohen me “.....pranë AKKP-së,” dhe fjalët “...të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së...” zëvendësohen me “...të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së...”.
 - b) Në shkronjat “a”, “b” e “c” fjalët “...lëshuar nga ZRPP-ja...” zëvendësohen me “...lëshuar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP-ja)...”.

3. Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) AKKP-ja, brenda 30 ditëve, por jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës e të dokumentacionit nga kërkuesi, kryen verifikimin e hollësishëm dhe konfirmon faktin, nëse kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues përmbushin kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi. Verifikimi i kushteve bëhet nëpërmjet inspektimit në terren nga punonjësit e AKKP-së. Gjithashtu, AKKP-ja i drejtohet organeve, që kanë lëshuar dokumentet me kërkesën për konfirmimin e vërtetësisë së tyre. Korrespondenca bëhet pjesë e dosjes. AKKP-ja ka detyrë të kryejë saktësimin e kufijve të sipërfaqes, që kërkohet të tjetërsohet, duke kryer matje në terren, kur rezulton se dokumentacioni tekniko-ligjor, i paraqitur nga kërkuesi nuk përmban kufij ose dokumentacioni teknik nuk është i plotë. Shpenzimet e verifikimit dhe të matjes në terren parapaguhet nga kërkuesi, sipas tarifës së miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Në përfundim të shqyrtimit sipas afateve të mësipërme, AKKP-ja ia përcjell Ministrisë së Drejtësisë dosjen e plotë së bashku me relacionin teknik, të shoqëruar me inventarin e dokumenteve.”.

b) Fjalja e parë e shkronjës “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“AKKP-ja pas përfundimit të relacionit teknik njofton kërkuesin sipas rastit për:”.

c) Nënndarja “i” e shkronjës “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i) përmbushjen e kriterëve të përcaktuara, si dhe detyrimin për të paguar, për llogari të AKKP-së, për fondin e kompensimit financiar, kaparin e përlllogaritur sipas këtij vendimi, të sipërfaqes që do të tjetërsohet. Në njoftim duhet të përfshihet përshkrimi i hollësishëm i sipërfaqes së bashku me planimetrinë;”.

ç) Në shkronjën “d” fjalët “...me rekomandimin e AKKP-së në qark,...” zëvendësohen me “...me rekomandimin e ish- zyrës rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (ish-ZRKKP-së)...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.251, datë 13.4.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.200, DATË 19.2.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE PËR PROCEDURËN E
TJETËRSIMIT TË OBORREVE NË PËRDORIM, PËR LLOGARI TË FONDIT TË
KOMPENSIMIT FINANCIAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 3, e 23, pika 1 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të neneve 24, shkronja “c”, e 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.200, datë 19.2.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 të ndarjes I të vendimit, pas fjalëve “...në funksion të një ndërtimi të ligjshëm...” shtohen “...për qëllime banimi...”.

2. Në nënndarjen “ii” të pikës 2 të ndarjes II, fjalët “...sipas aneksit 1...” zëvendësohen me “...sipas aneksit 2...”.

3. Në ndarjen III “Paraqitja e kërkesës dhe akteve provuese”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kërkesa plotësohet sipas formularit tip, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së. Formulari tip përmban një paralajmërim që ngarkon me përgjegjësi, sipas ligjit, subjektin kërkues në rast të deklarimit të të dhënave të rreme apo të depozitimit të dokumentacionit të falsifikuar.”.

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Ajo paraqitet nga kërkuesi pranë AKKP-së drejtpërdrejt ose nëpërmjet postës rekomande.”.

c) Në shkronjën “ç” të pikës 3, fjalët “...i nxjerrë nga Arkivi Qendror i Shtetit” zëvendësohen me “...i nxjerrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave...”.

ç) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Me paraqitjen e kërkesës paguhet edhe tarifa e shërbimit, niveli i së cilës përcaktohet me urdhër të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe të Ministrisë të Financave.”.

4. Në ndarjen IV “Procedura e shqyrtimit të kërkesës”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. AKKP-ja, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, por jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës e të dokumentacionit nga kërkuesi, shqyrton dhe jep vendim për të. AKKP-ja verifikon dhe përcakton, nëse kërkesa e dokumentacioni shoqëruar përmbushin kushtet e përcaktuara në ndarjen II të këtij vendimi, si dhe saktëson kufijtë e oborrit në përdorim, që kërkohet të tjetërsohet.

b) Kudo në pikën 2 fjalët “...zyra/zyrës rajonale...” zëvendësohen me “...AKKP-së/ja...”.

c) Në pikën 3 fjalët “...zyra rajonale...” zëvendësohen me “...AKKP-ja...”.

ç) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Në përfundim të shqyrtimit, AKKP-ja harton vlerësimin ligjor.”.

d) Shkronja “c” e pikës 5 shfuqizohet.

dh) Fjalja e parë e pikës 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në përfundim, AKKP-ja njofton kërkuesin, sipas rastit, për:”.

e) Pika 7 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.252, datë 13.4.2010

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 13.11.2007 PËR ÇËSHTJEN NR.38222/02 “RRAMADHI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës europiane për të drejtat e njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 13.11.2007 për çështjen nr.38222/02 “Rramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për shumën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) euro, si dhe për pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.

2. Interesi, që paguhet mbi këtë shumë, llogaritet nga data 13 gusht 2008 dhe është i barabartë me normën marzhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 (tre) për qind.

3. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim është data 15.4.2010.

4. Detyrimi financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

5. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve Shyqyri Rramadhi, Remzi Kapidani dhe Rabije Rramadhi, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.

6. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 4 të këtij vendimi në favor të ankuesve Shyqyri Rramadhi, Remzi Kapidani dhe Rabije Rramadhi, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.259, datë 27.4.2010

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
DOGANAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Endri Pema lirohet nga detyra e drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.
 2. Z.Flamur Gjymishka emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Doganave.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.2, datë 18.1.2010

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAU GRAMSH

Në mbështetje të neneve 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura ", të ndryshuar, si dhe metodikës "Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik" në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU- së

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.u, Gramsh, si më poshtë:
Për ujin e pijshëm
Konsumator familjar: 28.5 lekë/m³;
Institucion buxhetorë: 70 lekë/m³ ;
Ente private: 85 lekë/m³ .
2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2010 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.
3. Pagesa rregullatore për sh.a. Ujësjetës, Gramsh do të jete 1 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.3, datë 18.1.2010

PËR LICENCIMIN E OPERATORIT NDËRMARRJA E UK, BASHKIA PUKË

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë....." Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të licencojë operatorin Ndërmarrja e UK, bashkia Pukë me:
- Drejtues ligjor z. Halit Dini
- Drejtues teknik znj. Lindita Hyseni.
- 1.1 Operatori licencohet në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
- 1.2 Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri më datë 18.1.2014.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.6, datë 16.2.2010

PËR LICENCIMIN E OPERATORIT SHA UJËSJELLËS, VLORË

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence....." Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të licencojë operatorin sh.a. Ujësjiellës, Vlorë me:
 - Drejtues ligjor z. Viron Toli Hyso
 - Drejtues teknik znj. Albina Rushdi Xhyheri.
2. Operatori licencohet në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
3. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri më datë 16.2.2014.
4. Zona e shërbimit të këtij operatori është:
Bashkia: Vlorë
Komuna: Qendër
Fshati: Babicë, Nartë, Zvërnec.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.7, datë 19.2.2010

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAUK, KORÇË

Në mbështetje të neneve 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura ", të ndryshuar, si dhe metodikës "Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik " në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a.u.k., Korçë:
 - a) tarifat e ujit për konsum publik, si më poshtë:

	Për ujin e pijshëm		Për ujërat e ndotura
Konsumator familjar:	50	lekë/m ³	20 lekë/m ³ ;
Institucion buxhetor:	85	lekë/m ³	35 lekë/m ³ ;
Ente private:	114	lekë/m ³	37 lekë/m ³ .
b) tarifën mujore fikse të shërbimit:	80	lekë/ klient.	

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.3.2010 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

3. Pagesa rregullatore për sh.a.u.k., Korçë do të jetë 1.5 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.8, datë 25.2.2010

PËR RILICENCIMIN E OPERATORIT PËR EFEKT TË NDRYSHIMIT TË DREJTUESIT
TEKNIK SHA UJËSJELLËS, PËRMET

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë.....” Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të rilicencohet operatori sh.a Ujësjiellës, Përmet me:
 - Drejtues ligjor z.Thodhor Llazo Vangjeli;
 - Drejtues teknik z. Kristul Vangjel Thomollari.
2. Operatori rilicencohet në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është:
Bashkia: Përmet
Komuna: Petran
Fshati: Lipë, Skutaraq, Lëshicë, Qilarisht.
4. Kjo licencë është e vlefshme deri më datë 21.7.2012 siç është përcaktuar në vendimin nr.22 të KKRR-së në datën 21.7.2008.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM
Nr.9, datë 1.3.2010

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAUQ, FIER

Në mbështetje të neneve 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik” në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU- së

VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a.u.k., Fier:
 - a) tarifat e ujit për konsum publik si më poshtë:

	Për ujin e pijshëm		Për ujërat e ndotura
Konsumator familjar:	44	lekë/m ³	10 lekë/m ³ ;
Institucion buxhetor:	80	lekë/m ³	12 lekë/m ³ ;
Ente private:	100	lekë/m ³	14 lekë/m ³ .
Konsumatorë industrialë (ARMO,TEC,AZOTIK)	60	lekë/m ³	

b) tarifën mujore fikse të shërbimit: 100 lekë/ klient.

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.3.2010 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

3. Pagesa rregullatore për sh.a.u.k., Fier do të jetë 0.8 % e të ardhurave vjetore të llogaritura.

KRYETARI
Avni Dervishi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 27.4.2010

Doli nga shtypi më 28.4.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 28 lekë